

Njoftimi për përqendrim me të cilin personi fizik Arifi Selaudin, Kërçovë do të fitojë kontrollin mbi industrinë e furrës së bukës Zhito Karaorman SHA Kërçovë.

(lënda nr. 08-129/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 28.09. 2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin personi fizik Arifi Selaudin, Kërçovë ka fituar kontrollin mbi industrinë e furrës së bukës Zhito Karaorman SHA Kërçovë me seli në Bul. Ilinden nr.44 Kërçovë nëpërmjet shitblerjes së aksioneve .

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Industria e furrës së bukës Zito Karaorman SHA Kërçovë është e angazhuar në prodhimin e produkteve të mullirit

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

19.09.2023

Shkup